




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës
Municipality of Mitrovica
Municipality of Mitrovica

DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL



RAPORTI I PUNËS 2025

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Mitrovicë, 2025

HYRJE

Ky raport përmban një analizë të rezultateve, aktiviteteve dhe projekteve të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural lidhur me mbështetjen e fermerëve nga Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në bashkëpunim me MBPZHR-në, organizatat vendore dhe ndërkombëtare në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Komunën e Mitrovicës. Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural duke u bazuar në planifikimin e buxhetit për vitet 2025, në Planet e punës për vitet 2025, në kërkesat e qytetarëve, në bashkëpunim të ngushtë me organizatat vendore dhe ndërkombëtare, në bashkëpunim me MBPZHR në këtë periudhë ka realizuar një numër të madh të aktiviteteve dhe projekteve ku nëpërmjet subvencioneve, granteve dhe shërbimeve këshillimore janë ndihmuar fermerët dhe ekonomit bujqësore në rritjen e produktivitetit për sektorët prioritar, veçmas të blegtorisë, pemëve dhe perimeve.

Drejtorja për Bujqësi dhe Zhvillim Rural si drejtori e përbër nga një staf profesional angazhohet për të kontribuar në zhvillimin e kapaciteteve prodhuese bujqësore të fermerëve, ngritjen e fuqisë së tyre konkurruese në treg, të shpërndajë njohuri për praktikat më të mira të prodhimit bujqësorë duke zbatuar dhe lobuar politika dhe projekte që i kontribuojnë zhvillimit rural në Komunën tonë sipas standardeve të Bashkimit Evropian.

Për DBZHR-në dhe më tutje mbetet prioritet ngritja e njohurive dhe furnizimi me paisje të reja teknologjike tek fermerët dhe përfituesit e programeve tona me qëllim të ngritjes së prodhimtarisë, cilësisë, sasisë dhe uljes së kostos së prodhimit.

Drejtorja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural beson që me një bashkëpunim të ngushtë të ekipit profesional të drejtorisë, fermerëve, MBPZHR si dhe partnerëve strategjik do të arrijmë të kontribuojmë në Zhvillimin Rural dhe ekonomik në Komunën tonë dhe të kontribuojmë në zvogëlimin e importit dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

PËRSHKRIMI I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL NË KOMUNËN E MITROVICËS

Pozita gjeografike dhe kushtet e volitshme klimatike kanë ndikuar në zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë në këtë territor, duke u njohur si trevë në prodhimin e drithrave të bardha, perimeve dhe blegtorisë. Në tokat pjellore të Komunës rreth viteve 50-ta ndërtohen objektet industriale të Trepçës, duke zënë hapësirë prej 150 ha tokë e klasit të parë, kryesisht e kultivuar me perime. Sipërfaqja e gjithëmbarshme e Komunës së Mitrovicës është rreth 33.596 ha prej të cilëve 5.600 ha tokë të punuar, ku 400 ha pas luftës së fundit janë tjetërsuar nga ndërtimet e egra dhe gjithësejt kanë mbetur 5.200 ha tokë e punuar. Brenda Komunës së Mitrovicës, ka ndryshime të konsiderueshme si në kultivimin e kulturave bujqësore po ashtu edhe në sipërfaqet e tokës (madhësia e fermës). Në disa pjesë (fshatra) të Komunës së Mitrovicës ka dallime në zhvillimin e sektorëve të bujqësisë. Mund të thuhet se pjesa më e madhe e territorit të Komunës është mbuluar me tokë pjellore dhe ka klimë të përshtatshme, që garanton prodhimtari ekonomike dhe profitabile të drithërave, pemëve, perimeve dhe blegtorisë. Nga ekonomia bujqësore në Komunën e Mitrovicës rreth 15,000 banorë gjenerojnë të ardhura, ndërsa rreth 7,000 prej tyre janë aktivë në bujqësi. Karakteristikat e përgjithshme: pjellshmëria e tokës, kushtet klimatike, burime ujore, struktura e popullësisë, tregojnë se Mitrovica ka një potencial të favorshëm për zhvillimin e mëtutjeshëm të bujqësisë.

Bazuar në klimë përbrenda Komunës, rajoni i Mitrovicës ndahet në dy zona agro-ekologjike-prodhuese:

- Rajoni blegtoral i cili përfshin territorin e Shalës;
- Rajoni i prodhimeve bimore bujqësore i cili shtrihet përgjatë dhe për rreth pellgjeve të lumenjëve Ibër – Sitnicë – Lushtë.

Në pjesën e Shalës më tepër është i zhvilluar sektori i blegtorisë ndërsa pjesa rreth pellgjeve të lumenjëve Ibër – Sitnicë – Lushtë më tepër është i zhvilluar sektori i prodhimtarisë bimore. Aktualisht, në fshatrat e Komunës së Mitrovicës bujqësia është sektori më i rëndësishëm i ekonomisë. Megjithatë, prodhimi bujqësor në këtë rajon është i ulët në raport me kushtet agroekologjike që posedon potenciale të mundshme prodhuese dhe produktivitetit përkatës që haset në vendet e zhvilluara. Faktorët që ndikojnë në realizimin e rendimenteve të ulëta janë të shumtë, nga të cilët, për këtë regjion, mund t'i veçojmë: niveli i ulët i teknologjisë së zbatuar në prodhimtari, përdorimi i farërave dhe inputeve të tjera jocalësore

PROJEKTET DHE AKTIVITETET E REALIZUAR NGA DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL


Drejtorja për Bujqësi dhe Zhvillim Rural duke u bazuar në planifikimin e buxhetit për 2025, në Planet e punës për vitin 2025, në kërkesat e qytetarëve, në bashkëpunim të ngushtë me organizatat vendore dhe ndërkombëtare, në bashkëpunim me MBPZHR ka realizuar një numër të madh të aktiviteteve dhe projekteve ku nëpërmjet subvencioneve, granteve dhe shërbimeve këshillimore të DBZHR, MBPZHR janë ndihmuar fermerët dhe ekonomit bujqësore në rritjen e produktivitetit për sektorët prioritarë, veçmas të blegtorisë, pemëve dhe perimeve.

DBZHR në bashkëpunim me Drejtoritë përkatëse Komunale dhe në bashkëpunim me MBPZHR- në këtë periudhë ka kryer aktivitetet kryesore të Drejtorisë që kryesisht janë zhvilluar në këto drejtime:

- I. Fusha e aktiviteteve të rregullta të Drejtorisë;
- II. Fusha e realizimit të projekteve;
- III. Fusha e bashkëpunimit.

I. Fusha e aktiviteteve të rregullta të Drejtorisë

1. Përmes këtij sistemi është bërë aplikimi dhe dixhitalizimi për pagesa direkte për 27 kultura bujqësore (grurë, misher, pemë dhe perime) në vitin 2025, aplikimi fermerëve bëhet në zyrët komunale në DBZHR. ***Sistemi i Identifikimit të Parcelave të Tokës (s LPI)***



3. Mbajtja e trajnimeve dhe dhënia e këshillave për fermerë të profileve të ndryshme nga ana e stafit të Drejtorisë dhe MBPZHR

Edukimi dhe trajnimi i fermerëve në zonat rurale. Në kuadër të aktivitetit janë formuar module të trajnimeve si moduli i qumështit, perimeve dhe pemëve. Qëllimi i këtyre trajnimeve ka qenë që fermerët të trajnohen në të gjitha sektoret e bujqësisë. Janë trajnuar në module të ndryshme si: Trajnime në modulën e qumështit, menaxhimit të fermës, mbrojtjes së pemëve, mbrojtjes së tokës bujqësore, përdorimit të pesticideve, mbrojtjes së bletëve, kultivimi i pemëve të imta, kultivimi i perimeve në fushë të hapur dhe të mbylluar etj.

Rëndësi të veçantë është kushtuar edhe organizimit të trajnimeve të ndryshme me fermerët tanë, duke bashkëpunuar me MBPZHR, me qëllim ngritjen e aftësive profesionale të tyre, si:

- *Prodhi i prodhimeve tradicionale;*
- *Higjiena e qumështit;*
- *Menaxhimi i fermave;*
- *Mbrojtja e perimeve nga sëmundjet në serra;*
- *Mbajtja e shënimeve në fermë;*
- *Mënyra e kultivimit të grurit me teknologji bashkëkohore;*
- *Njoftim i fermerëve për mënyrën e aplikimit të subvencioneve;*
- *Mënyra bashkëkohore e të krasiturit të pemëve, mbrojtjes dhe ruajtjes së tyre etj.*

4. Hartimi i propozim-projekteve dhe projekteve për donator në sektorët e ndryshëm:

- *Sektorin e bletarisë (pajisje për bletari);*
- *Sektorin e pemëtarisë (ngritje të sipërfaqeve me pemë të imta);*
- *Sektorin e perimtarisë ngritja e serrave;*
- *Sektorin e blegtorisë (pikat gumbulluse të qumështit);*
- *Sektorin e mekanizimit bujqësorë pajisje për të gjitha sektorë;*
- *Sektorin e bimëve mjeksore dhe aromatike (pikatgrumbulluse të bimëve mjeksore) etj*

5. Promovimi i bujqësisë dhe zhvillimit rural

- *Panairi i prodhimeve vendore;*
- *Panairi i "Shpeztarisë";*
- *Organizimi i konferencave;*
- *Prezantimi i raportit;*
- *Organizimi i tryezave etj*

6. Aktivitetet e tjera të DBZHR:

- *Angazhime në Programin e Shërbimeve Këshillimore të MBPZHR;*
- *Mbledhje e shënimeve dhe statistikave për fermer dhe përcjellja e tyre në MBPZHR;*
- *Planifikimi dhe realizimi i mbjelljeve pranverore;*
- *Vlerësimi i dhënies së pëlqimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore;*
- *Monitorimi i punës së therrtorës;*
- *Aplikimi i fermerëve për subvencione për mbjelljet vjeshtore dhe pranverore nga MBPZHR;*
- *Planifikimi dhe realizimi i mbjelljeve vjeshtore;*
- *Monitorimi i sëmundjeve dhe dëmtueseve të bimëve bujqësore dhe bimëve dekorative;*
- *Monitorimi i fermerëve që merren me prodhimin e perimeve në ambiente të mbrojtura;*
- *Përgaditja e programeve për mbrojtjen e bimëve nga ADB;*
- *Udhëzime dhe ndihmë për fermerë për të aplikuar në grante të ndryshme etj.*

PROJEKTET E REALIZUAR NGA DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural duke u bazuar në planifikimin e buxhetit për vitin 2025, në Planin e punës për vitet 2022-2025, në kërkesat e qytetarëve, ka realizuar një numër të madh të projekteve në sektor të ndryshëm të bujqësisë siq janë:

1. Fondi për bashkëfinansim të projekteve me IADK-në

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim dhe bashkëfinansim me IADK-në është në proces të realizimit të projektit “**Fondi për bashkëfinansim të projekteve me IADK-në**”. Projekti është mbikëqyrur nga stafi profesional i IADK-së dhe DBZHR-së me qëllim që projekti të realizohet sa më mirë. Në kuadër të këtij projekti janë përkrahur **12** fermerë grante nga sektori i bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Vlera e projektit:

DBZHR – 6,240.00 €

IADK - 22,560.00 €

Përfituesi – 2,400.00 €

Vlera totale e projektit: 31,200.00€

2. Organizimi i panairove “Konaku i Mitrovicës” dhe aktivitetet tjera promovuese

Panairi është mbajtur dy javë nga data: 07.07.2025 deri 13.07.2025 dhe nga data 16.07.2025 deri 21.07.2025, ku fermeret dhe ndërmarrëset gra kanë promovuar produktet e tyre bujqësore- vendore (përpunim të pemëve, perimeve dhe ushqimeve tradicionale).

Numri i pjesëmarrjes së fermereve dhe ndërmarrëseve - 16

Vlera totale e projektit: 15,000.00€

3.Përkrahje e sektorit të Perimtarisë-Subvencionimi i fermerëve me serra të tipit Tunel

DBZHR duke e parë interesimin e madh të fermerëve për ngritjen e serrave dhe gjendjen ekonomike jo të favorshme në këtë sektor, ka realizuar projektin për ngritjen e serrave të tipit Tunel nga polietileni me sip. 50m², ku përmes këtij projekti ka përkrahur 52 përfitues /prodhues të perimeve.

Vlera e projektit 50,000.00 euro.

4.Përkrahje e sektorit të Perimtarisë-Subvencionimi i fermerëve me serra të tipit Tunel në bashkëfinancim me Chatar Charity

Për shkak të numrit të madh të kërkesave për serra të tipit tunel DBZHR në bashkëfinancim me Chatar Charity ka realizuar projektin për ngritjen e serrave të tipit tunel me sip.96m², ku kanë përfituar 44 përfitues / prodhues të perimeve.

Vlera e projektit :

DBZHR - 27,772.80 €

Chatar Charity - 30,087.20 €

Vlera totale e projektit: 57,860,00 €

Përkrahja e fermerëve nga fatkeqësit natyrore

Fermerët e përkrahur nga fatkeqësit natyrore i takojn kryesisht sektorit të blegtorisë

Nr. i përkrahur i fermerëve: 31

Vlera totale : 7,140.00€

Marrëveshje bashkëfinancimi me Ibër Lepencin – për ujitjen e kulturave bujqësore në Komunën e Mitrovicës

Bazuar në kërkesat dhe nevojat e fermerëve të Komunës dhe në përputhje të politikave të Komunës së Mitrovicës në bashkpunim me Ibër Lepencin është realizuar projekti për ujitjen e kulturave bujqësore në Komunën e Mitrovicës me qëllim të përkrahjes së bujqëve, duke ndikuar në këtë formë në rritjen e rendimenteve bujqësore. Komuna e Mitrovicës ka marr përsipër pagesën për ujitje deri në 200ha.

Vlera e projektit: 22,000.00€

Projektet të cilat janë realizuar nga Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillimit Rural për vitin 2025

Projektet	Mënyra e pagesës	Bashkfinç. (€)	Nr. i përfituesve	Koment
Grante për bujqësi	DBZHR IADK Përfituesi Totali	6,240.00 € 22,560.00 € 2,400.00 € 31,200,00 €	12	
Organizimi i panairëve''Konaku i Mitrovicës "dhe aktivitetet tjera promovuse	DBZHR	15,000.00 € 15,000,00 €	27	
Subvencionimi i fermerëve me serra të tipit Tunel nga plietileni (50 m2)	DBZHR Totali	50,000.00 € 50,000,00 €	52	
Subvencionimi i fermerëve me serra të tipit Tunel nga plietileni (96 m2)në bashkfinancim me organizatën Chatar Charity	DBZHR Chatar Charity	27,772.80 € 30,087.20 € 57,860,00 €	44	
Përkrahja e fermerëve nga fatkeqësit natyrore		7,140.00€	31	
Marrveshje bashkfinancim me Ibër Lepenc- për ujitjen e kulturave bujqësore në Kom. e Mitrovicës	DBZHR	22,000.00€	38	
Totali		183,200€	205	

Subvencionimi i fermerëve dhe ekonomive bujqësore në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, projekte të financuar nga MBPZHR të realizuara në bashkëpunim me DBZHR.

- ***Përkrahje e sektorit të Lavërtarisë - Subvencione për mbjellje të grurit.*** Projekt i financuar nga MBPZHR. Të drejt aplikimi kanë pasur fermerët që kanë mbjellur 1 e më shumë hektarë me grurë. Projekt realizohet përmes aplikimit. Aplikimi dhe digjitalizimi me eLPIS i parcelave është realizuar në DBRZH.

- ***Përkrahje e sektorit të Lavërtarisë -Subvencione për mbjellje të misërit.*** Projekt i financuar nga MBPZHR. Të drejt aplikimi kanë pasur fermerët që kanë mbjellur 1 e më shumë hektarë me misër. Projekt realizohet përmes aplikimit. Aplikimi dhe digjitalizimi me eLPIS i parcelave është realizuar në DBZHR.

- ***Përkrahje e sektorit të blegtorisë - Subvencione për lopë qumështore.*** Projekt i financuar nga MBPZHR. Si kriter ka qenë numri i krerëve (minimumi 5 lopë qumështore). Projekt realizohet përmes aplikimit. Aplikimi dhe regjistrimi fermerit në EFR është duke u realizuar në DBZHR.

- ***Përkrahje e sektorit të blegtorisë - Subvencione për kafshë të imëta (dele dhe dhi).*** Projekt i financuar nga MBPZHR. Si kriter ka qenë numri i krerëve (për dele 30, për dhi 20). Projekt realizohet përmes aplikimit. Aplikimi dhe regjistrimi fermerit në EFR është duke u realizuar në DBZHR.

- ***Përkrahje e sektorit të bletarisë - Subvencione për shoqëri të bletëve .*** Projekt i financuar nga MBPZHR. Si kriter ka qenë numri i shoqërive të bletëve (mbi 30 shoqëri bletësh). Projekt realizohet përmes aplikimit. Aplikimi dhe regjistrimi fermerit në EFR është duke u realizuar në DBZHR.

- ***Përkrahje e sektorit të perimtarisë–Subvencionimi i fermerëve për njësi të sipërfaqes (hektar) së mbjellë me perime në fushë të hapur.*** Projekt i financuar nga MBPZHR. Të drejt aplikimi kanë pasur fermerët që kanë mbjellur 0.5 e më shumë hektarë me perime. Projekt realizohet përmes aplikimit. Aplikimi dhe digjitalizimi me eLPIS i parcelave është realizuar në DBRZH.

- ***Përkrahje e sektorit të pemtarisë–Subvencionimi i fermerëve për njësi të sipërfaqes (hektar) së mbjellë me perime në fushë të hapur.*** Projekt i financuar nga MBPZHR. Të drejt aplikimi kanë pasur fermerët që kanë mbjellur 0.5 e më shumë hektarë me pemë. Projekt realizohet përmes aplikimit. Aplikimi dhe digjitalizimi me eLPIS i parcelave është realizuar në DBRZH.

Fusha e Bashkëpunimit

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural është duke bashkëpunuar mirë me MBPZHR, drejtorit komunale, organizatat vendore dhe ndëkombetare rreth realizimit dhe implementimit të projekteve në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Bashkëpunim i mirë ekziston edhe me OJQ-ët e ndryshme ku pritët të realizohen një sërë projektësh të përbashkëta në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural do të vazhdojë të bashkëpunoj ngushtë me të gjitha institucionet relevante, organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare për të qenë vazhdimisht në rrjedha dhe në shërbim të qytetarëve dhe fermerëve.

Drejtor


Remzije Tupella

